



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr.20, datë 06.11.2018

**PËR**

**“RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT EKZISTUESE DHE SHITESË NË SIPËRFAQE PËR OBJEKTIN: “KAPANON INDUSTRIAL “ALBACO SHOES” PËR AKTIVITET PRODHIMI 1 DHE 2 KAT”, ME VENDNDODHJE NË AUTOSTRADËN TIRANË-DURRËS, KM 5, KASHAR, BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Albaco Shoes” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit ekzistuese dhe shtesë në sipërfaqe për objektin: “Kapanon industrial “Albaco Shoes” për aktivitet prodhimi 1 dhe 2 kat”, me vendndodhje në Autostradën Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Albaco Shoes” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, datë 07.03.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumenti i ri i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOGA

